

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD

RAPORTI TEKNIK

SHTESE 3KT TE SHKOLLES
9-VJEÇARE "VILSON BLOSHMI" DHE
NDËRTIM I PALESTRËS"



NENTOR
2017

INFORMACION I PERGJITHSHEM

- Hyrje

Bashkia e Librazhdit, sipas kerkesave te Detyres se Projektimit, kërkon të realizojë projektin e zbatimit për objektin: SHESE 3KT TE SHKOLLES 9-VJEÇARE "VILSON BLOSHMI" DHE NDËRTIM I PALESTRËS", në qytetin e Librazhdit.

Realizimi i ketij Projekti, ka si qëllim prioritar dhe final, permiresimin e kushteve te mesimdhenies ne shkollen Vilson Blloshmi.

- Vendodhja e objektit

Shkolla 9-vjeçare Vilson Blloshmi, ndodhet ne qytetin e Librazhdit. Shkolla kufizohet:

Nga Lindja	- Truall Privat
Nga Veriu	- Rruge Lagjeje
Nga Perendimi	- Rruge Lagjeje
Nga Jugu	- Truall Privat



Foto ajrore e shkolles

- Përshkrim i Pergjithshem

Shkolla Vilson Blloshmi është një godinë e vjetër 3KT e ndërtuar pas viteve 90. Shkolla ka sipërfaqe totale të territorit, Siperfaqe Trualli prej 6465 m² nga ku sipërfaqe e përdorur për ndërtim është 603 m² gjurma e shkollës ekzistuese (1800 m² ndërtim total). Shtesa 3 kateshe që do të bashkëngjitet shkollës ekzistuese ka një gjurmë me sipërfaqe prej 199 m² dhe 597 m² ndërtim total.

- Kapaciteti

Godina është 3 kate dhe ka 682 nxënës. Mësimi zhvillohet me 1 turn. Numri i klasave mësimore është 22 dhe ka 31 nxënës /klasë. Ka 1 laborator kimie, 1 laborator biologjie dhe 1 laborator kompjuteri, mungon palestra.

- Përshkrimi i gjendjes aktuale të objektit

Shkolla përbehet nga një godinë 3KT. Shkolla është e vjetër, dhe në përgjithësi paraqitet në gjendje të mirë, megjithatë mirëmbajtja në disa aspekte ka qenë e dobët.

Grupi i projektimit, pasi u njoh fillimisht me detyrën e Projektimit, inspektoi objektin për të verifikuar gjendjen faktike, si dhe për të evidentuar problemet specifike që kërkojnë ndërhyrje. Në këtë kuader Grupi i Projektimit zhvilloi dhe takime me Drejtuesit e Shkollës si dhe me personelin arsimor, nga të cilët u njoh edhe me anën funksionale të ambjenteve të shkollës.

Nga inspektimi i Shkollës u evidentuan këto probleme:

Për sa më sipër, objekti që trajtohet në këtë studim projektim është:

Shtesa 3kt në shkollën 9-vjecare **"Vilson Blloshmi"** dhe ndërtim i Palestres.



Foto te gjendjes ekzistuese te shkolles

Vlerësimi fizik i objektit:

Shkolla ka mungesë të ambjenteve për zhvillimin e programit mësimor dhe vërehen probleme të cilat kërkojnë të ndërhyjmë sa më parë për t'i eliminuar dhe mos të rëndohen më tepër. Nga një vlerësim paraprak rezulton:

- Mungon palestra për zhvillimin e lëndës së edukimit fizik;
- Mungon sistemi i MNZ-së;

Pershkrimi i nderhyrjes

Grupi i projektimit pas vizites ne objekt dhe analizes qe i beri gjendjes ekzistuese mbeshtetur dhe ne kerkesat e detyres se projektimit, me projektin e paraqitur synon te permiresoje kushtet e mesimdhënies duke bere keto nderhyrje:

Ndertim te nje shtese te re prej tre kateve me nje siperqafe prej 199 m2 ne kat. Shtesa do te permbaje 3 klasa ne kat, dhe ne cdo kat nje hapësire te shfrytezueshme per depo.

Ndertimin e nje palestres, nje terreni sportiv te hapur dhe sistemimin e oborrit.

Instalimin e sistemit te ngrohjes qendrore.

**RELACIONI KONSTRUKTIV
U PERGATITEN NGA GRUPI I INXHINIEREVE
Ing. Rexhep TARBA**

**PËR "ZENIT&CO" SH.P.K.
ADMINISTRATORI**

LUIZA TARBA

